

GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ – DEPARTAMENTI PËR KRIME TË RËNDA, sipas gjyqtarit Ibrahim Idrizi kryetar i trupit gjykues, me sekretaren juridike Qendresa Bobi në lëndën penale kundër të akuzuarit N.T. për shkak të vepres penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së sipas aktakuzës së prokurorisë Komonale në Ferizaj PP.nr 69/15 të datës 20,05,2015 pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar me 19.10.2015 në prani të Prokurorit të shtetit Florie Salihu Shamolli dhe të akuzuarit N.T. shpall dhe publikisht komunikon këtë.

A K T G J Y K I M

I akuzuari N.T. nga fshati, K.Kaqanik data e lindejs..... në të njejëtin vend, nga i ati I. dhe e ëma M. e gjinis L. me numer personal,shqiptar shtetas i R.Kosovës, ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i martuar, prind i 3 fëmijëve i gjendëjes së dobët ekonomike, mbrohet në liri.

Është fajtor

Nga data e pa përcaktuar deri në datën 26.04.2015 në shtëpinë e tij në fsh....., K. Kaqanik, gjatë një kontrolli nga ana e policisë tek i pandehuri janë gjetur një revole e tipit TT me 5 fishek të kalibrit 7.62 mm, prodhim jugosllav si dhe një pushkë gjuetie e mdoelit Sarzilmaz me numër serik 111809 dhe 2 fishek të paautorizuar në kundërshtim me ligjin e zbatueshëm të armëve të cilat armë ju kanë konfiskuar nga ana e policisë, me këtë ka krzer vepër penale mbajtja në pronësi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së,

Andaj gjzkata në bazë të nenëve 4,7,17,21,41,46,73 e 374 par. 1 të KPRK-së si dhe të nenit 365 të KPPK-së.

E G J Y K O N

Me dënim gjobe në shumë prej gjashqindë (600) E.

Dënimin e shqiptuar me gjbë i akuzuari do të paguajë pasi aktgjykimi të merr formën e prerë.

Në rast se dënimi i shqiptuar me gjobë nuk mund të ekzekutohet në format e parapara në nenin 39 të KPPK-së, dënimi me gjobë do ti zëvendësphet me dënim burgimi ashtu që për çdo ditë burgimi do ti llogaritet shuma prej 15 euro.

Konfiskohen në mënyrë të përherëshme revolva e tipit TT me 5 fishke të kalibrit 7.62 mm, prodhim jugosllav si dhe një pushkë gjuetie e modelit Sarzimaz ne numer serik 111809 dhe 2 fishek të armës së gjuetisë.

Obligohet i akuzuari që kësaj Gjykate të ia paguaj paushallin gjyqësor në shumë prej nga 30 (tridhjetë) euro, në afat prej 30 ditëve pasi që aktgjykimi të merr formën e prerë.

A r s y e t i m i

Historiku i procedurës

Prokuroria Themelore në Ferizaj – Departamenti per Krime te Renda ka ushtruar aktakuzën PP.I.nr. 69/15 me dt. 20.05.2015, ndaj të akuzuarit N.T. për shkakë të veprës penale mbajtja në pronsi, kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së

Duke vepruar sipas kësaj akuze në këtë gjykatë me 19.10.2015 është mbajtur shqyrtimi fillestar sipas dispozitave të nenit 245 të KPPK-së

Pranimi i fajësisë nga i akuzuari N.T.

I akuzuari N.T. në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësin për veprën penale mbajtja në pronësi ose posedim te paautorizuar te armëve nga neni 374 par.1 të KPRK-së , ecila vepër i vihet në barrë me akuzën e prokurorit të shetitit.

Ka deklaruar se pushkën e gjuetisë që i është sekuestruar a ka pasur me leje por që në kohën kur i ka skaduar organi kompetent nuk ka lëshuar leje me tutje dhe për këtë arsye edhe nuk ka aplikuar për tu vazhduar leja dhe ndoshta edhe ka gabuar për këtë e ka bërë duke mos qenë i njoftar se duhet të ri apikohet pavarësisht faktit se organi i Punëve të Brendëshme nuk ka lëshuar leje një kohë, është hera e parë që ka kryer vepra penale si dhe gjendja e tij ekonomike është shumë e dobët.

Vlerësimi i pranimit të fajësis

Kryetari i trupit gjykues në shqyrtimin fillestar konstatoi se i akuzuari e kka pranuar fajësinë pasi që ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajit, pranimi i fajit është bërë në mënyr vullnetare si dhe pranimi i fajit është mbështetur në të gjitha faktet dhe provat e paraqitura nga prokurori në aktakuzë dhe me këtë janë përmbushur të gjitha kushtet ligjore të parapara në nenin 248 të KPPK-së dhe në këtë mënyrë shqyrtimi fillestar e ka pëfunduar pa administruar provat e tjera dhe ka vazhduar me shqiptimin e dënimit siç parashihet në paragrafin 4 të nenit 248 të KPP-së.

Vlerësimi ligjor i veprimeve të të akzuarit

Kryetari i trupit gjykues po ashtu konstatoi se në veprimet e të akzuarit ekzistojnë të gjitha tiparet e veprës penale , mbajtja në pronësi , kontroll ose posedim të paautorizuar të armëve nga neni 374 par. 1 të KPRK-së , për të cilën veprë i akuzuari është penalisht përgjegjës dhe është ndëshkuar si në dispozitivin e këtij aktgjykimi.

Vlerësimi i dënimit për të akzuarin

Me rastin e matjes së dënimit gjykata pati parasysh të gjitha rrethanat nga neni 73 i KPPK-së, të cilat ndikojnë në zbutjen apo ashpërimin e dënimit.

Si rrethan lehtësuese për të akzuarin gjykata ka marr për bazë pranimin e fajsisë nga i akuzuari pendimin e tij për kryerjen e kësaj vepre penale, korrekte gjatë tërë procedurësi dhe në shqyrtimin fillestar , ndërsa si rrethanë rënduese gjykata pati parasysh faktin se vepra e tillë penale është e përhapur mjaft dhe paraqet një rrezikshmëri të caktuar shoqërore.

Gjykata është e bindur se dërimi i shqiptuar ndaj të akzuarit është në harmoni me peshën e veprës penale, me shkallën e përgjegjësis penale të të akzuarit dhe dënimin e shqiptuar me kusht do të arrihet qëlimi i dënimit i paraparë në nenin 34 të KPPK-së.

Shpenzimet e procedurës penale

Vendmimi për shpenzimet e procedurës penale është bazuar në nenin 453 të KPPK-së.

Vendimi për konfiskimin e armëve është i bazuar në nenin 374 par. 5 të KPRK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ
DEPARTAMENTI PER KRIME TE RENDA
PKR. 104/15
të dt. 19.10.2015**

**Sekretarja juridike,
Qendresa Bobi**

**Gjyqtari,
Ibrahim Idrizi**

KËSHILLA JURIDIKE:

Kundër këtij aktgjykimi mundë të ushtrohet ankes,në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit, Gjykatës së Apelit në Prishtinë,përmes kësaj Gjykate .

